



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Shkurt
2022

TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT GJATË VITIT 2021

PREZANTUAR ME RASTIN E
CEREMONISË PËRKUJTIMORE
TË 31 VJETORIT TË
THEMELIMIT TË KOMITETIT
SHQIPTAR TË HELSINKIT





ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Ky raport është përgatitur nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Gjetjet dhe konkluzionet e pasqyruara në këtë raport vjetor, janë kontribut i një sërë nismash të zbatuara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit gjatë vitit 2021.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit.

Përgatitën:

1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Koordinatorë e Projektit Klinika Ligjore Falas, KShH
2. Znj. Servete Çeka, Juriste/Paraligjore në Projektin Klinika Ligjore Falas, KShH

Rishikuan:

1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH
2. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt”

Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

Përmbajtja


Historik	4
Fjalët Përshëndetëse	5
Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH)	5
1. Përmbledhje Ekzekutive	11
2. Ankesat dhe kërkesat e qytetarëve drejtuar Komitetit Shqiptar i Helsinkit gjatë vitit 2021	15
2.1. Të dhëna statistikore për subjektet ankues dhe shërbimet ligjore të ofruara	15
2.2. Vlerësimi i KShH-së për të drejtat dhe liritë e cënuara	16
3. Ndërhyrjet institucionale për trajtimin e ankesave	17
4. Reagimet Publike	19
5. Oponencat ligjore në procesin legjislativ	20
6. Përfaqësimi i çështjeve me natyrë strategjike për të drejtat dhe liritë e njeriut	21
6.1 Çështjet e përfaqësuara pranë Gjykatës Kushtetuese	21
6.2. Çështjet e përfaqësuara pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Strasburgut)	22
6.3. Efikasiteti i vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në sistemin tonë të brendshëm	23
7. E drejta e informimit në epokën e re dixhitale dhe në situatën e pandemisë globale	25
7.1. Ankesat për informacion pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	25
7.2. Impakti i vendimmarrjeve të Komisionerit dhe roli i tij në raport me institucionet publike	26
7.3. E drejta për informacion përkundrejt nevojës për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe parimit të prezumimit të pafajësisë	26

Historik

Në 16 dhjetor 1990, në kontekstin e valës së parë të lëvizjeve për transformimin demokratik të Shqipërisë, një grup intelektualësh publikë themeluan Forumin Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, i cili më vonë u emërtua “Komiteti Shqiptar i Helsinkit” (KSHH). KSHH u themelua që në krye të herës si një organizatë me anëtarësi dhe si një subjekt jofitimprurës, joqeveritar dhe jopartiak. Organizata u fokusua fillimisht në të drejtat e personave të persekutuar nga regjimi totalitar, që sundoi Shqipërinë në gjysmën e dytë të shekullit XX, dhe luajti rol udhëheqës në edukimin e shoqërisë shqiptare lidhur me kuadrin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Në 22 mars të vitit 1992 KSHH u bë anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, me qendër në Vjenë. Në këtë çerek shekulli, KSHH ka qenë dhe mbetet organizata më në zë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, si dhe një partner kryesor për organizatat e tjera joqeveritare, institucionet publike shqiptare, agjenci dhe programe ndërkombëtare që punojnë për përparimin e respektimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri. KSHH me qendër në Tiranë ushtron veprimtarinë e tij në të gjithë Shqipërinë. Gjithashtu, në Kukës, Gjirokastrë, Fier, Vlorë, Korçë, Elbasan, Shkodër tashmë funksionon një rrjet korrespondentësh që ka qëllim vëzhgimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në fusha të ndryshme në rrethet përkatëse.

Me rastin e 31 vjetorit të themelimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), vlerësuam zhvillimin e një eventi modest, me pjesëmarrjen e një rrethi të ngushtë bashkëpunëtorësh dhe aktivistësh si dhe me pjesëmarrjen e nderuar të Anëtarëve të Asamblesë. Ky event u hap me fjalët përshëndetëse të disa nga anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme si dhe anëtarëve themelues, të cilët ndanë copëza të përvojës së tyre përgjatë 31 viteve të ekzistencës së Komitetit Shqiptar të Helsinkit.



Fjalët Përshëndetëse

Anëtarët e Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH)



Znj. Vjollca Meçaj, Presidente e Asamblesë.

“Kremtimi i përvjetorëve është momet krenarie dhe kënaqësie por dhe një moment i rëndësishëm për reflektim. Në këtë kuadër kam nderin dhe kënaqësinë të shpreh disa konsiderata lidhur me organizatën, me misionin, objektivat e saj ndër vite, përfshirë dhe ato për të ardhmen.

31 vjet më parë, më 16 Dhjetor 1990, ndërkohë që kishte filluar lëvizja popullore për më shumë liri dhe demokraci në vend, mediat vendase, por edhe disa ndërkombetare, njoftuan se në Tiranë, krahas partive të reja opozitare, ishte themeluar dhe organizata e parë joqeveritare, jofitimprurëse dhe e pavarur politikisht, e emërtuar "Forumi Shqiptar për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut". Më pas, me përfshirjen në rrjetet ndërkombetare të organizatave si motra, ajo ndryshoi emrin në "Komiteti Shqiptar i Helsinkit".

Intelektualët e shquar, që u bashkuan në këtë nismë themeluese, kuptuan se lëvizja e re politike që synonte t'i hapte rrugen transformimit të madh politiko-shoqëror, me qëllim instalimin e sistemit demokratik edhe në vendin tonë, nuk mund të kryhej pa pjesëmarrjen e gjerë të shtetasve, pa i pajisur ata me një kuptim të drejtë mbi organizimin e funksionimin e sistemit të ri, pa iu garantuar atyre, realisht, liritë dhe të drejtat themelore, pa zgjedhje të lira e të drejta për organet e pushtetit shtetëror.

Për këto arsye, por jo vetëm, misioni i KShH ishte dhe mbeti në vazhdimësi, promovimi dhe mbrojtja e lirive themelore dhe të drejtave të njeriut, si dhe forcimi i demokracisë dhe shtetit të së drejtës.

Aksionet kryesore të ndërmarra kanë qenë të fokusuara, kryesisht, në nxitjen e përmirësimit të legjislacionit, që garanton dhe mbron liritë themelore dhe të drejtat e njeriut dhe zbatimit të drejtë të tij; monitorimi i institucioneve publike lidhur me respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut; edukimi i publikut me njohuri rreth këtyre lirive dhe të drejtave; si dhe ndjekja e rasteve konkrete të cenimit të tyre, qoftë në rrugë administrative, apo gjyqësore.

Gjetjet e konstatuara, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, së bashku me rekomandimet e rastit, vazhdimisht u janë përcjellë organeve kompetente, subjekteve të interesuara dhe, sipa rastit, janë bërë të njohura edhe për publikun e gjerë.

Rruga e ndjekur ka qenë e gjatë, me shumë vështirësi dhe dilema, por shpesh jemi shpërblyer me kënaqësinë e sukseseve. Morali, fryma dhe përkushtimi i atyre që themeluan organizatën, i anëtarëve që kontribuan ndër vite në Asamblenë e Përgjithshme (organi më i lartë vendimmarrës

së organizatës) si dhe i stafit të punësuar, kanë qenë e mbeten në lartësinë e duhur. Bashkëpunimi me OJF të tjera, vendase dhe të huaja, si dhe me vullnetarë, që na janë afruar për ndihmë, kanë qenë mbështetje në përmushjen e detyrave.

Dhe angazhimi ynë vazhdon. Jeta ecën përpara dhe bashkë me të rritet nevoja për forcimin e demokracisë, për standarde më të larta të qeverisje së mirë, për liri më të gjerë, rritjen e mirëqenies dhe sigurisë në të ardhmen. Jo vetëm vendi ynë, por dhe popujt e tjerë të Ballkanit perëndimor, janë përfshirë, gjithashtu, në këto përpjekje, duke patur si qëllim kryesor integrimin evropian.

Pavarësisht rolit të madh të klasës politike në këtë drejtim, këto përpjekje kërkojnë, pa dyshim, pjesëmarrjen e gjerë të shtetasve, si dhe rolin e Shoqërisë Civile dhe të OJF-ve në veçanti. Këto të fundit, të zhveshura nga anësitë politike, nga interesat fitimprurëse dhe luftën për pushtet, mbeten aktorët më idealistë dhe më të sinqertë në përpjekjet e sipërshënuara por edhe me ekspertizë të spikatur në fushat që përbëjnë misionin e tyre. Ndaj, mendoj se, në këto momente të rëndësishme të demokracive të reja të vendeve tona, duhet të angazhohemi më shumë dhe veprimtaritë tona t'i përshtatim gjithnjë e më mirë me nevojat konkrete të zhvillimit të vendit.

Miqtë tanë ndërkombëtarë, që na mbështetin në procesin e integritit evropian dhe forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës, janë shprehur qartë se i konsiderojnë edhe strukturat e ShC si partnerë, duke nxitur dhe organet e qeverisjes në vendet tona ta ndjekin këtë model. Këtë ata e manifestojnë jo vetëm me mbështetjen finaciare, e morale ndaj nesh por dhe duke na dëgjuar me vëmendje për problemet që parashatrojmë, kur punojmë seriozisht. KShH, por dhe organizata të tjera, pjesëmarrëse në këtë takim, mund të tregojnë plot eksperiencë pozitive në këtë drejtim (Rasti i fundit i Komisionit të Venecias). Por sfidat e OJF-ve janë më të mëdha kur duhet të adresojnë sugjerimet e vërejtjet përpara organeve të qeverisjes në vend, ndonëse bashkëpunimi i tyre me ne është i sanksionuar në ligj.

Nga ana tjetër sa më shumë vendi avancohet në procesin e integritit evropian aq më të ndërlikuara do të jenë problematikat me të cilat do të duhet të angazhohemi. Kjo do të kërkojë planifikim më të mirë për veprimtarinë që do të zhvillojmë, si dhe rritje të mëtejshme të kapaciteteve për përballimin e problematikave të pritshme. Partneritet më i gjërë me organizata të tjera, brenda e jashtë vendit do të ndihmojë për fuqizimin e ndërhyrjeve tona.”



Z. Kujtim Çashku, Themelues dhe Anëtar i Asamblesë.

Pas 30 vitesh të aktivitetit në Komitetin Shqiptar të Helsinkit, kuptoj se vitet rendin shumë shpejt dhe ndërkohë bashkë me vitet që ikin memoria e secilit nga ne bëhet gjithnjë e më pasur. Si e tillë duket sikur memoria që pasurohet na merr vite nga jeta duke na pasuruar në një sens tjetër. Në këtë konflikt të brëndëshëm mes viteve dhe memories individi e motivon ekzistencën e vet kur ruan një element të fuqishëm njerëzor siç është dimensionin i mirënjohjes.

Me këtë rast do doja t'u shprehja mirënjohjen time të thellë, të gjithë atyre që e themeluan forumin e parë të drejtave të njeriut në Shqipëri më 16 Dhjetor 1990. Një pjesë e tyre tashmë nuk jetojnë më, si prof. Kristo Frashëri, Prof Arben Puto, Prof Ylli Popa, Jusuf Vrioni, Maks Velo, Viktor Dosti etj, por dhe të tjerë si Besnik Mustafaj, Elsa Ballauri, Remzi Lani, Fatos Lubonja, Abdi Baleta, Bashkim Shehu, Zana Shuteriqi, Mentor Petrela, Piro Misha, e të tjerë duke kërkuar ndjesë për ata që s'po më kujtohen tani në këtë takim.

Në atë kohë, në burgjet Shqiptare gjëndeshin një numër i madh të burgosurish politik dhe plot të internuar në zona të ndryshme të vendit. Përbërja e Komitetit të Helsinkit ishte me njerëz me backgrounde të ndryshme. Në të bëni pjesë ish të dënuar politikë, ish komunistë, njerëz të pavarur. të moshave nga më të ndryshmet. Kjo, krijojnë brënda komitetit një klimë tolerance dhe reflektimi, një lloj arkitekture ndryshe të të menduarit, ndryshe nga qëndrimet përjashtuese e staliniste të regjimit komunist. Për t'u rikthyer tek dimensionin i mirënjohjes si vlerë e rëndësishme krahasimore e kujtimeve të hidhura apo të bukura që memorizohen tek secili nga ne, dua të vazhdoj t'u shpreh mirënjohjen, aktivistëve të huaj të të drejtave të njeriut që punuan me ne si përfaqësues të Amnesty International dhe të Helsinki Federation. Ata n'a dhanë hartat dhe listat e të burgosurve politik në Shqipëri. Unë ruaj një mirënjohje të thellë ndaj Melany Anderson. Jan Jansen, Berit Becker, Lord Nicholas Bethell, Theodor Orlin, Ted Zeng, Christopher Hill, Gerald Nagler, Bjorn Engesland, Catherine Lalumiere, Suzi McClear, e të tjerë në pamundësi për të rënditur të gjithë emrat e tyre në këtë bisedë. Me listën e të burgosurve politikë në dorë ne i kërkuam Ministrin të Brendshëm të kohës, Hekuran Isai që të vizitonim burgjet dhe të liroheshin sa më parë të burgosurit politik. Fjalët e para që dëgjua prej tij ishin se Shqipëria nuk ka të burgosur politikë dhe se ne ishim të shitur tek Perëndimi. Po flasim për fillimin e vitit 91, ku në sheshin qendror të Tiranës ishte ende statuja e Enver Hoxhës. Natyrisht pas atij takimi me ne, mund të ndodhte gjithçka. Sigurimi i shtetit ishte ende nëpër rrugë e kudo. Zoti Lutfi Dervishi më tha që ti drejtohem njerëzve të cilët janë në një moshë të re dhe nuk e imagjinojnë ende kohën e diktaturës. Personalisht mendoj se nuk duhet që të rinjë t'u projektojmë modelin përjashtues dhe ekstremist të urrejtjes. Jam i bindur që ndëshkimi më i madh ndaj një memorie të keqe e kriminale diktatoriale është ndëshkimi që kryhet nga transparenca dhe thënia e të vërtetave të ndodhura. Pra aspekti kryesor i dimensionit të të drejtave të njeriut është vendosja e një raporti të drejtë dhe human me të vërtetën. Sa më parë t'a fitojmë këtë vetëdije ne Shqiptarët, aq më humane, të çliruar e të lirë do jemi, prej fantazmave të së shkuarës.

Në memorien time ka mbetur biseda në burg me ish ministrin e brendshëm Hekuran Isaijin. Së bashku me aktivisten amerikane, Suzi Maclear kur Hekuran Isaijin e burgosëm pas ca vitesh, ne

e vizituam atë në burg dhe u intresuam për të ditur se si po e trajtonin autoritet e burgut. Kur na pa si përfaqësues të Komitetit të Helsinkit të shoqëruar dhe nga amerikan ai bëri çudi. E pyetëm se çfarë pakënaqësish kishte ndaj administratës së burgut dhe nëse ishte torturuar fizikisht apo psikjikisht prej tyre. Ai na tha diçka që në memorien time ka mbetur e pashlyer. “Vini re, dritaren e qelisë sime sa e vogël është. Në kohën e fashizmit ishte tre here më e madhe. Mirëpo kur erdhëm ne komunistët e bëmë sa një vrimë miu. Kur nuk e kisha menduar se një ditë do të vija unë vetë si I burgosur këtu”. E kujtoj këtë moment, se thënia e tij në atë kohë më ka bërë të kuptoj gradualisht se të drejtat e çdo kujt mbarojnë kur ti vetë i shkel të drejtat e tjetrit.

Pra në atë kohë, kuptova që shpesh herë fenomeni i të drejtave të njeriut është një transferë i të drejtës nga vetja tek tjetri dhe anasjelltas. Qëllimi është se si t’a vësh veten ti në pozicioni e tjetrit. Ajo e keqe, që i ndodh atij mund të ndodhë edhe ty neser. Them se, jo për mua, por besoj për të gjithë neve bashkë, anëtarë të Asamblesë së Komitetit por dhe të tjerë vetë Komitetite i Helsinkit ka qënë një shkollë më vete madje edhe për shumë të rinj që kanë ardhur e bashkëpunuar me ne. Kujtoj se një pjesë jo e vogël e tyre kanë bërë karriera, janë bërë ministra, deputetë etj, si Besnik Mustafaj, Vasilika Hysi, Artur Metani etj. Të tjerë ish anëtar kanë krijuar shoqata specifike të drejtave të njeriut, si Altini Hazizaj që merret kryesisht me të drejtat e fëmijëve, apo Elsa Ballauri me Akademinë dhe grupin për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Ky peisazh është pasuruar shumë gjatë k’tyre 30 viteve. Këtu në këtë takim kemi dhe anëtarin e KSHK znj. Luljeta Lleshanaku e cila aktualisht merret me të gjithë dokumentimin dhe krijimin e gjithë dosjeve, dokumentave të plota që kanë të bëjnë me krimet e kryera gjatë kohës së komunizmit. Jam i gëzuar që Komiteti Helsinkit me Drejtoren Ekzekutive Erida Skëndaj vazhdon të jetë një forcë motorike dhe gjallërie në mbrojtje të principeve të deklaratës universal të të drejtave të njeriut dhe gjithë konventave që rrjedhin prej saj. Mos i mendondojmë kurrë se të drejtat e njeriut janë diçka stacionare që filluan këtu e mabaruan atje. Ato mbeten një aspirate e përvetshme sepse njerëzit nuk mund të ekzistojnë pa mbrrojtur vlerat e tyre humane të fituar me mund e sakrifica ndër shekuj në çdo skaj të botës ku ato ndodhen.

Unë do të ndërpres këtu fjalën dhe më falni që ju mora kohë e falemnderit për durimin. Po ja kjo është e keqja që kur pushtohesh nga kujtime, nuk është e lehtë as që ti administrosh ato. Madje mund të biesh viktimë dhe e këtij mikrofonit dhe e faktit që ju po më dëgjoni në këto mumente. Ju kërkoj ndjesë për që ju mora nga këto sekonda të jetës suaj.

Faleminderit!”



Z. Lutfi Dervishi, Anëtar i Asamblesë së Përgjithshme.

“Dje ishte 31 vjetori i krijimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, i cili është një moment për të festuar po dhe për të pasur një moment reflektimi për çfarë është arritur, për çfarë mund të bëhet më mirë. Mund të thuash shumë fjalë por ndoshta një pyetje ka vlerë, le të imagjinojmë për një moment sikur KShH të mos ekzistonte, që nga Dhjetori i vitit 1990 deri tani, çfarë do të kishim humbur? Do të kujtoj që është organizata e parë joqeveritare në Shqipëri dhe nëse kthejmë pak memorien në shekullin e kaluar, jemi në kohën kur koncepti i organizatave joqeveritare nuk ekzistonte, ku njerzit që punonin me fondet e donatoreve quheshin spiunë, agjent të huaj, në shërbim të armiqve të vendit, etj.

Cila ka qënë deklarata e parë e KShH në atë kohë? Lirimi i të burgosurve politikë. Sot mund të tingëllojë si një kërkesë normale, një nga themeluesit që sot është në panel Kujtim Çashku mund të sjellë ndoshta në një ndërhyrje të tij edhe atmosferën e asaj kohe. Në atë kohë ka qënë një akt i guximshëm, kur merr parasysh gjendjen në të cilën ndodhej shoqëria shqipëtare që i ngjante Koresë së Veriut.

Por nëse kthehemi në vitin 2021, 31 vite në tranzicion çfarë sjell dhe çfarë ka sjellë KShH? Vetëm nëse rikujtojmë në mënyrë të përmbledhur pak momente, një shoqëri të polarizuar ku për dekada duket që nuk ka pasur shqiptarë, por ka pasur demokratë në një anë, socialistë në anën tjetër, që të jesh i pavarur do të thotë të kesh dy armiq. Në fakt, KShH ka arritur të ketë dy “miq”. I vë në thonjëza sepse në momente të caktuara, për interesa të caktuara si njerëz nga e majta si nga e djathta, si nga lart si nga poshtë i janë referuar punës së KShH-së!

KSHH ka spikatur këto kohë jo vetëm si organizatë që promovon, lufton, mbron të drejtat e njeriut, shtresat e marginalizuara por edhe për zgjerimin e spektrit të punës, duke skanuar jo vetëm tre pushtetet (legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin) por edhe një pushtet tjetër që shpesh është agresiv dhe tenton të gëlltisë edhe pushtet e tjera! E kam fjalën për pushtetin e medias.

KSHH ka dhënë një kontribut mjaft të rëndësishëm përmes studimeve të veçanta për gjëndjen e komunitetit të gazetarëve për gjëndjen e lirisë së shprehjes, për gjëndjen e lirisë së medias, për të kapur probleme të izoluar, por edhe për të “kapur” dhe shpjeguar mekanizmin që i prodhon këto probleme.

Po KShH është marrë edhe me çështje individuale psh kur mori një çështje në burgun e Zaharisë dhe dërgoi në gjykatën e Strasburgut dhe arrin të fitojë çështje, mendoj që është një moment për t’u duartrokatur. Megjithëse jemi në një konflikt interesi, unë ju ftoj për një duartrokitje për punën e gjithësecilit prej jush dhe sidomos të pjesës ekzekutive të Komitetit që ka arritur t’i japë opinionit shqiptar një zë profesional dhe të besueshëm. Me këto dy fjalë realisht dua një duartrokitje.

Takimi sot ka një dimension më të madh. Lë themi është një takim rajonal ku pas pandemisë ka filluar të përqafohet i kombinuar i realizimit të veprimtarive, ku kemi të ftuar fizikisht dhe miq online. Këto pak kohë që do flasim do të sjellim në fokus këtë 31 vjetor i cili nuk është një kapitull

për tu mbyllur por është thjesht një gur kilometrik për të ecur më tej sepse edhe sfidat janë të tjera. Në shekullin e kaluar nuk kanë qënë fjalët dixhitalizim i të drejtave online, ne sot këtu do flasim edhe për hapësirën dixhitale, duke qënë se ne shumicën e kohës e kalojmë online edhe sfidat e së ardhmes do na vijnë online të gërshetuara.”



1. Përmbledhje Ekzekutive

Misioni i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KSHH) është të kontribuojë në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, forcimin e shtetit të së drejtës dhe zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, në përputhje me Kushtetutën tonë dhe aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë. Në kuadër të përmbushjes së misionit të tij, KShH ka monitoruar në mënyrë proaktive situatën e të drejtave të njeriut në vendin tonë si dhe ka advokuar me institucionet shtetërore për respektimin më të mirë të tyre.

Shtyllë e rëndësishme e veprimtarisë së KShH-së është kontakti me njerëzit dhe trajtimi i ankesave të tyre duke ofruar shërbime ligjore falas dhe ndërhyrje pranë institucioneve. Për shkak të kufizimit të lirisë, kanë vijuar të kenë prioritet në veprimtarinë tonë edhe gjatë vitit 2021, shqetësimet apo kërkesat e shtetasve të paraburgosur apo të dënuar në sistemin penitenciar. Ankesat më të shumta janë për cënimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në cënim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku problematike vazhdojnë të jenë vonesat dhe tej zgjatja e proceseve gjyqësore. Herë pas herë, KShH ka marrë ankesa nga të dënuarit apo familjarët e tyre, për kushte fizike të akomodimit apo trajtim ç'njerëzor apo degradues si dhe për shkelje që dobësojnë kontaktet me familjarët, një element shumë i rëndësishëm për ri-integrimin e të dënuarve.

KShH jo vetëm ka ndërhyrë pranë institucioneve shtetërore duke përcjellë sipas fushës së kompetencës së tyre, ankesat e ndryshme të paraqitura nga qytetarët, por në disa raste ndërhyrjet tona janë shtjelluar me sugjerimet apo rekomandimet përkatëse. Gjatë këtij viti, KShH ka realizuar rreth 78 ndërhyrje pranë organeve të ndryshme publike. Organet publike i janë përgjigjur 43% të ankesave të përcjella pranë tyre (ose ndryshe për 34 raste). Por edhe në këto raste, janë vërejtur tejkalim i afateve ligjore, çka ka sjellë në disa raste ushtrimin nga KShH, të së drejtës së ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Më shumë bashkëpunuese, për shkak edhe të natyrës së ankesave, janë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale. Mgjth, edhe në rastet kur institucionet janë përgjigjur, për disa ankesa, informacioni rezulton jo i plotë si dhe nuk realizohet një verifikim i plotë dhe objektiv i ankesës. Në disa raste përgjigjet e dhëna kanë elementë paragjykues ndaj ankuesve, si përsëmbull ankesat justifikohen me faktin se shtetasit e privuar nga liria kanë probleme të shëndetit mendor.

Kushtet e pandemisë kanë sjellë disa vështirësi në realizimin e veprimtarisë dhe përmbushjen e misionit të KShH-së. Edhe në këtë situatë, KShH ka realizuar tre misione monitorimi me qëllim verifikimin e pretendimeve të cënimit të të drejtave dhe lirive, bazuar në ankesat e qytetarëve ose të sinjalizuara nga media. Gjatë këtyre misionëve monitorimi, ka patur raste kur përfaqësuesit e institucioneve nuk kanë respektuar parimet e përgjegjshmërisë, llogaridhënies dhe transparencës, për të adresuar mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave themelore të njeriut.

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë së KShH-së vijnë të jenë reagimet publike për çështje shqetësuese të cënimit të të drejtave të qytetarëve dhe interesit publik. KShH ka reaguar me 21

deklarata ose njoftime për shtyp, sidomos gjatë periudhës se zgjedhjeve në vend, apo edhe për çështje të tjera me rëndësi si akses në drejtësi, nevoja për parandalimin e kriminalitetit, dhënia fund e gjuhës së urrejtjes në parlament, respektimi i dëgjësive dhe konsultimit efektiv me qytetarët dhe grupet e interesit në kuadër të procesit ligjbërës, etj. Në këto reagime, përveçse ka shprehur shqetësimin, KShH në shumë raste ka dhënë edhe rekomanime konkrete për zgjidhjen apo adresimin e çështjes. Në frymën e këtyre deklaratave publike kanë qënë edhe disa reagime të përbashkëta me organizata të tjera të shoqërisë civile.

Kontributin e saj modest, KShH ka vijuar ta ofrojë formën e oponencës ligjore gjatë procesit ligjbërës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë. Në këtë drejtim, vërejmë se shqetësimet e mëparshme për konsultime në afate të ngushta dhe mungesë reagimi për komentet dhe sugjerimet e adresuara vijnë në të jenë prezent edhe përgjatë këtij viti.

Përgjatë vitit 2021, Komiteti Shqiptar i Helsinkit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të dispozitave që parashikojnë përdorimin e makinës të së vërtetës në dy ligje¹ si dhe dispozitat që parashikonin përgjimin dhe gjurmimin e autorëve të veprave penale nga Policia e Shtetit, pa një miratim paraprak nga ana e Prokurorisë². Kërkesa jonë e parë u pranua vetëm pjesërisht nga Gjykata Kushtetuese, vendimet e të cilës janë të detyrueshme për zbatim. Mëjth, ky vendim në vlerësimin tonë ka elementë kontradiktor dhe nuk është arsyetuar plotësisht. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për kërkesën e dytë është në favor të kërtimeve të Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Institucionit të Avokatit të Popullit.

Pas ezaurimit të rrugëve gjyqësore në vend, KShH ka luajtur një rol proaktiv në asistencën e ofruar ndaj shtetasve shqiptarë për t'ju drejtuar dhe përfaqësuar para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), çështje të natyrës strategjike që kanë të bëjnë me shkelje të të drejtave të parashikuara në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (kryesisht për trajtimin ç'njerëzor dhe poshtërues, të drejtën e votës së shtetasve të privuar nga liria, procesin e rregullt ligjor dhe të drejtën për një mjet juridik efektiv) . Me vendimin e dt. 9 Dhjetor 2021, GJEDNJ-së vendosi të ç'regjistrojë kërkesën e të dënuarit shqiptar të përfaqësuar nga KShH, Fotaq Zaharia, i cili prej 10 vitesh është në pritje të realizimit të një ndërhyrje kirurgjikale në këmbën e tij, e cila nuk i është garantuar konform rekomandimit të mjekëve specialistë. Kjo situatë ka sjellë përkeqësimin e gjendjes së tij shëndetësore. Kjo vendimmarrje e GJEDNJ-së edhe pse nuk përmbush plotësisht kërkimet e të dënuarit, përbën zhvillim pozitiv pasi autoritetet shqiptare pranojnë dhe shprehin keqardhjen që i dënuari i është nënshtruar trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, duke u zotuar ndër të tjerash se do të ofrojnë shërbim adekuat mjekësor si dhe do ti paguajnë atij një shumë prej 13,000 euro (trembëdhjetë mijë euro) për të mbuluar çdo dëm material dhe jomaterial.

¹ Neni 34, pika 2, gërma gj) dhe 38 pika 2 gërma e) të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", si dhe nenit 38 pika 2 të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme".

² Neni 131 i ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" i ndryshuar me ligjin nr. 133/2020

Për dy çështjet e përfaqësuara me sukses, më herët nga KShH, vërehet se edhe pse ka kaluar më shumë se dy vjet nga vendimi përfundimtar i GJEDNJ-së “Prizreni kundër Shqipërisë” dhe më shumë se një vit e gjysëm për vendimin përfundimtar të GJEDNJ-së “Strazimiri kundër Shqipërisë”, nuk është ekzekutuar shpërblimi i drejtë që i është akorduar kërkuarve shqiptarë nga Gjykata e Strasburgut. Mosekzekutimi në kohë i vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, vendos në pikëpyetje efikasitetin e mbrojtjes që Konventa Evropiane duhet të ofrojë për shkeljet ndaj qytetarëve nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës.

Në çështjen “Strazimiri k. Shqipërisë”, GJEDNJ i kërkon shtetit Shqiptar zgjidhje efektive dhe përfundimtare si rezultat i mungesës së një institucioni të posaçëm mjekësor të akomodimit të shtetasve me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Vlen të theksohet se në fund të muajit nëntor të këtij viti është mbyllur Burgu i Zaharisë, ku ndër të tjerash ishin akomoduar shtetasit (burra) me masë mjekësore “mjekim i detyruar”. Në zbatim të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë, është realizuar transferimi i tyre në dy godinat e përshtatura në IEVP Shënkoll (Lezhë).³ KShH ka reaguar publikisht duke vlerësuar si pozitiv mbylljen e burgut të Zaharisë, për shkak të kushteve të këqija infrastrukturore, të cilat vendosnin shtetasit me liri të kufizuar, përfshirë ata me masë mjekësore, në pozita të trajtimit ç’njerëzor dhe poshtërues. Megjithatë, dy godinat akomoduese, pjesë e IEVP Shën Koll nuk plotësojnë kërkesat ligjore të një institucioni të posaçëm të kujdesit shëndetësor për shtetasit me masë mjekësore. Gjithashtu, vërehet numër i ulët i mjekëve psikiatër dhe psikologëve në këto godina në raport me numrin e lartë të shtetasve me masë mjekësore. Për më tepër, kjo zgjidhje e përkohshme nuk mundëson akomodimin e vajzave dhe grave me masë mjekësore “mjekim i detyruar”, të cilat prej vitesh mbahen në ambientet e Qendrës Spitalore të Burgjeve.

E rëndësishme në misionin e KShH vazhdon të mbetet mbrojtja e të drejtës për informim e cila i shërben jo vetëm transparencës së institucioneve por edhe informimit të qytetarëve dhe publikut në tërësi. Gjatë këtij viti, KShH i është drejtuar 16 herë Komisionerit për Mbrojtjen e të Drejtës së Informimit dhe të Dhënave Personale. Këto ankime administrative janë depozituar ndaj autoriteteve publike që nuk kanë respektuar afatet ligjore për percjelljen e informacionit ose nuk kanë dhënë informacionin e plotë sipas kërkesës së dërguar nga KShH. Në 15 prej rasteve, institucionet kanë kthyer përgjigje vetëm gjatë procedurës së hetimit administrativ nga Komisioneri. Në asnjë rast, ndaj këtyre institucioneve (veçanërisht për shkelje të përsëritura), Komisioneri nuk ka marrë masa administrative për moszbatimin e ligjit për të drejtën e informimit.

KShH gjatë këtij viti ka parë si shqetësuese cënimin e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe prezumimit të pafajësisë sidomos në hapësirën online, por edhe nga mediat disa herë. Zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe rritja e përdoruesve të internetit dhe rrjeteve sociale kanë bërë që edhe në vendin tonë të ketë shqetësime për gjuhën e urrejtjes, bullizmin dhe cënimin e privatësisë së njerëzve. Gjithashtu, në median e shkruar dhe atë online ka patur raste të cënimit të parimit të prezumimit të pafajësisë, në mbulimin e ngjarjeve të kronikës së zezë të lidhura me kriminalitetin në vend. Mungesa e etikës parlamentare në disa raste ka evidentuar element të gjuhës së urrejtjes dhe bullizmit.

³ Informacion i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet shkresës nr. 12815/2 prot., dt 03.12.2021

Shumë gazetarë të intervistuar në kuadër të Barometrit Kombëtar për Lirinë e Shprehjes⁴ deklarojnë se kanë qenë të detyruar të vetë-censurohen ose ndeshen me raste të censurës në redaksitë ku punojnë apo pronarët e medias. Konkretisht, 49.5% e të anketuarve pohuan se ishin censuruar, pasi u ishte kërkuar direkt nga pronari apo përmes redaktorit apo kryeredaktorit, të mos publikonin një lajm. Në këtë kategori, 40% e të anketuarve specifikuan rastet kur kjo kishte ndodhur, kryesisht për ngjarje apo çështje që kanë qenë në vëmendje publike së fundmi. Ndër rastet e përmendura si censurë janë raportime për koncensionet për ndërtimin e inceneratorëve për menaxhimin e mbetjeve, interesa që preknin rrethin shoqëror apo të lidhura me biznesin në raport me punëdhënësin, protestës dhe çështjes së lidhur me prishjen e Teatrit Kombëtar, etj”.

Viti 2021 ka qenë dhe viti i zgjedhjeve parlamentare në vendin tonë, të cilin KShH e ka monitoruar. Shpesh herë kemi reaguar ndaj shkeljeve të raportuara nga vëzhguesit, sidomos për respektimin e të drejtës për votë të lirë, të fshehtë dhe të barabartë.

Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit Evropian për mbrojtjen e të dhënave personale 2016/679 dhe Direktivën e Politikës 2016/680, katër precedentë të rrjedhjeve masive të të dhënave personale dhe sensitive tronditën mbarë opinionin publik në Shqipëri, përkatësisht në prill dhe dhjetor, të vitit 2021.

Rasti i parë konsistoi në publikimin gjatë periudhës parazgjedhore të një databaze, me të dhëna personale dhe sensitive të afro 900 mijë votuesve. Sipas mediave, kjo bazë të dhënash administrohej nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste”. KShH tërhoqi vëmendjen se asnjë subjekt zgjedhor nuk mund të mbajë të dhëna personale dhe sensitive të zgjedhësve, pa miratimin paraprak të tyre si dhe kërkoj nga organi i prokurorisë të hetojë me objektivitet dhe në mënyrë të plotë çështjen në fjalë. Më dt. 19 Gusht 2021, në faqen zyrtare të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) u publikua një relacion, i cili ofronte informacion mbi procedurën e hetimit administrativ kryesisht (*ex officio*) që ky institucion ka ndërmarrë për përhapjen e paligjshme të këtyre të dhënave.⁵ Gjithashtu, zyra e Komisionerit ka marrë dhe ka trajtuar rreth 81 ankesa të adresuara nga qytetarë të ndryshëm kundrejt entiteteve publike ose private.⁶ Hetimi administrative i KDIMDP-së evidentoi se asnjë nga partitë politike në vendin tonë nuk e ka plotësuar formularin e njoftimit të KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale të qytetarëve. KDIMDP dha disa rekomandime ndaj Partisë Socialiste në gusht të vitit të kaluar⁷. Disa nga rekomandimet drejtuar ndaj këtij subjekti nuk përmbajnë një afat të qartë për tu përmbushur, por referohen për t'u adresuar në vazhdimësi.

⁴ Link: <https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2021/10/Barometri-Kombetar-per-Lirine-e-Media-2020.pdf>

⁵ [Relacion hetimi administrative per perhapjen e paligjshme te te dhenave personale te shtetasve.pdf \(idp.al\)](#)

⁶ Nga relacioni rezulton se janë adresuar: a. 2 ankesa për Lapsi.al; b. 4 ankesa për DPGJC; c. 31 ankesa për AKSHI; ç. 1 ankesë për DPT d. 40 ankesa për PSSH; dh. 1 ankesë për subjektin politik BD; si dhe e. 2 ankesa për një kandidat për deputet.

⁷ Rekomandime janë adresuar gjithashtu ndaj institucioneve publike, të cilat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi kanë kompetenca në raport me garantimin e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve, si ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

Lidhur me databazën e patronazhistëve, pas regjistrimit të procedimit penal nën kualifikimin e nenit 328 të Kodit Penal “Korrupsion aktiv në zgjedhje”, në fillim të muajit Tetor 2021 SPAK bëri me dije për mediat shpalljen e moskompetencës, me arsyetimin se nuk ka elementë të veprave penale të korrupsionit, duke e transferuar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Hetimi nga Prokuroria duhet të jetë efikas, i paanshëm dhe në kohë të arsyeshme. Në të kundërt provat mund të dëmtohen, manipulohen apo asgjësohen. Hetimi i Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me kompetencën lëndore dhe rrethin e subjekteve, duhet të shtrihet edhe ndaj zyrtarëve të lartë publikë të institucioneve shtetërore, të cilat dyshohen se kanë nxjerrë apo transferuar të dhënat. KShH vëren se mungesa e përgjegjshmërisë dhe pandëshkueshmëria cënon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës si dhe dobëson demokracinë.

Rasti i dytë dhe i tretë konsiston në publikimin dhe shpërndarjen përmes rrjetit të komunikimit “Whatsapp”, të një baze të dhënash të rreth 630,000 punonjësve në sektorin publik dhe privat, në lidhje me numrin e identifikimit, punëdhënësit dhe pagat e muajit janar dhe prill 2021. Pas disa ditësh u publikua një tjetër bazë të dhënash me të dhëna për pronarët e automjeteve, duke përfshirë modelin dhe targën për secilin prej tyre. Një numër i papërcaktuar qytetarësh kanë akses në këto baza të të dhënave për shkak të shpërndarjes së tyre. Referuar kërkesës që KShH i dërgoi KDIMDP-së, rezulton se ky i fundit ka nisur një hetim administrativ dhe po shikon mundësinë për të bashkëpunuar me administratorët e aplikacionit Whatsapp për të gjetur kanalet e duhura të komunikimit, në mënyrë që baza e të dhënave të mos vazhdojë të shpërndahet.

Sipas legjislacionit shqiptar, KDIMDP është autoriteti përgjegjës dhe i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë drejtim, nevojitet një vlerësim objektiv parlamentar nëse buxheti, burimet njerëzore dhe kapacitetet e KDIMDP-së, mundësojnë kryerjen e kontroleve periodike në të gjitha subjektet publike dhe private që janë “Kontrollues” apo “Kontrollues të mundshëm” të të dhënave personale të qytetarëve. Vlen të theksohet se niveli i njohurive dhe reagimit të qytetarëve shqiptarë mbi legjislacionin për të dhënat personale dhe mjetet juridike që shtetasit kanë në dispozicion kur ka shkelje, rezulton në nivele shumë të ulëta.

2. Ankesat dhe kërkesat e qytetarëve drejtuar Komitetit Shqiptar i Helsinkit gjatë vitit 2021

2.1. Të dhëna statistikore për subjektet ankues dhe shërbimet ligjore të ofruara

Gjatë vitit 2021, KShH ka trajtuar 292 ankesa të përcjella nga qytetarët. Këto ankesa kanë ardhur kryesisht nga persona të ndodhur në kushtet e heqjes apo kufizimit të lirisë (122 ankesa ose 41.7%). Ankesat janë marrë në rrugë të ndryshme, me anë të kontakteve të realizuara në terren drejtpërsëdrejti me qytetarët ose në forma të tjera si me korrespondencë të shkruar (letër, email ose rrjete sociale), në rrugë telefonike apo edhe takimet në zyrë ose në terren.

Në ndihmë të ankuesve, KShH ka ofruar orientimin e nevojshëm për rrugët ligjore që duhet të ndjekin dhe në raste të caktuara i ka ndihmuar të hartojnë dokumentacionin ligjor, të adresojnë shqetësimet e tyre pranë organeve kompetente ose duke ofruar ndihmë juridike falas për ti përfaqësuar në gjykatë. Vlen të theksohet se përparësi në ofrimin e shërbimeve ligjore falas i është

dhënë njerëzve në nevojë, përkatësisht të dënuarve, të paraburgosurve, individëve në kushte të vështira sociale ekonomike (të papunësuar, persona përfitues të ndihmës ekonomike, etj), personave që i përkasin komunitetit LGBTI, etj. Numri i shtuar i ankesave nga një anë tregon besueshmërinë që ata kanë tek KShH-ja, por nga ana tjetër ky është një tregues që vërteton se ende organet shtetërore nuk tregojnë vëmendjen e duhur për zgjidhjen e drejtë dhe në kohë të kërkesave dhe ankesave të tyre.

2.2. Vlerësimi i KShH-së për të drejtat dhe liritë e cënuara

Ankesat më të shumta i korrespondojnë pretendimeve për mosrespektim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në cënim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Problematike vazhdojnë të jenë vonesat dhe tej zgjatja e proceseve gjyqësore.

Ndër rastet flagrante të konstatuara është identifikuar ankesa e adresuar nga shtetasi i dënuar F.Z., i cili pretendon se procesi gjyqësor në ngarkim të tij ka zgjatur, duke u shndërruar në pengesë për aksesin efektiv në drejtësi, brenda afateve të arsyeshme procedurale. Ky shtetas përfaqësohet ligjërisht edhe pranë instancave gjyqësore vendase e ndërkombëtare nga avokatët e KShH-së. Ndërkohë që rreth 2 vite kanë kaluar nga momenti i regjistrimit të ankimit për zënie afati pranë Gjykatës së Apelit Tiranë,⁸ por nga kjo e fundit nuk është marrë masë për zëvendësimin e relatorit të çështjes, pas shkarkimit të tij nga vettingu dhe përcaktimin e një date mbi shqyrtimin e saj. KShH, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të kërkuarit i është drejtuar nëpërmjet një kërkesë zyrtare⁹ kreut të Gjykatës, me qëllim marrjen e masave administrative për hedhjen e shortit dhe caktimin e trupës gjyqësore, në proporcion me garantimin e të drejtës së procesit të rregullt ligjor të të burgosurit F.Z. Pavarësisht kësaj kërkesë, ende nuk ka një zgjidhje konkrete të komunikuar.

KShH vlerëson se mosmarrja e masave efektive nga ana e përfaqësuesve të sistemit gjyqësor, si dhe mosvënja në dijeni e palëve ndërgjyqëse rreth planit për zgjidhjen efektive të çështjes, ka cënuar aksesin në drejtësi të shtetasit dhe të drejtën për të përfituar nga një proces i rregullt ligjor, brenda afateve proporcionale të përcaktuara në kuadrin ligjor vendas.

Shumica e personave që ndodhen në kushtet e lirisë së kufizuar janë ankuar për mostransferimin në institucione afër vendbanimit të familjarëve të tyre apo vendosjes në institucione ku kanë probleme sigurie me të dënuarit/paraburgosurit e tjerë, larg familjarëve apo si rezultat i kërkimit të një të drejte. Ankesat në sistemin e burgjeve janë të lidhura gjithashtu me mungesën e shërbimit adekuat ose të specializuar mjekësor, për cënimin e korrespondencës apo takimeve të kufizuara, për ushtrim dhune psikologjike apo fizike e cila më së shumti pretendohet nga persona me të cilët ndajnë të njëjtën dhomë, etj.

Sa i takon ankesave të shtetasve të privuar nga liria në sistemin penitenciar, lidhur me trajtimin dhe dënimin ç'njerëzor ose poshtërues, KShH ka ndërmarrë edhe misione monitorimi në terren. Në kuadër të këtyre vizitave janë vërejtur raste të cënimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në muajin Prill 2021, KShH monitoroi kushtet e akomodimit, respektimin e të drejtave

⁸ Ankim për zënie afati është depozituar më dt. 21.12.2018

⁹ Shkresë nr. 382 prot., dt. 05.05.2021

procedurale gjatë fazës së pranimit në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe verifikoi pretendimin e ngritur nga shtetasi A.P, për mos realizimin e ekspertimit mjeko-ligjor brenda afateve të arsyeshme në momentin e arrestimit. Vëzhguesit e KShH-së morën kontakt me shtetasin e paraburgosur në IEVP 3012, i akuzuar si autor i ngjarjes së rëndë që përgjaku procesin elektoral parlamentar në Qytetin e Elbasanit, në Prill të vitit 2021. KShH vërejti se shenja e dëmtimit (objektivisht e verifikueshme) në dorën e të paraburgosurit nuk është regjistruar dhe as dokumentuar nga stafi mjekësor në momentin e pranimit në IEVP. KShH adresoi gjetjet dhe rekomandimet e tij drejt IEVP 302¹⁰. Ky rast evidentoi mosrespektimin e procedurave ligjore nga stafi mjekësor, të parashikuara në ligjin nr. 81/2020, për regjistrimin e provave ndikuese në zbardhjen e së vërtetës.

Pjesa më e madhe e ankesave të shtetasve të tjerë kanë të bëjnë me çështjet e pronësisë, ankesa që lidhen me të drejtën e informimit, ankesa për procedurat jo transparente nga organet e administrates qendrore dhe vendore etj.

Ankuesja I.M. pas ndjekjes së kalvarit të gjatë administrativ pranë organeve të pushtetit vendor, ju drejtua KShH-së duke pretenduar cënim të së drejtës së pronësisë, për shkak të mos ofrimit të informacionit mbi procedurën që po ndiqet për ekzekutimin e vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave për dëmshpërblimin e saj si bashkëpronare e pronës së shpronësuar për interes publik. Pas shqyrtimit të çështjes nga ana e avokatëve të KShH-së u konstatua se nga ana institucioneve nuk po i vihej në dispozicion as dokumentacioni përkatës për regjistrimin e pasurisë së paluajtshme, një kusht i domosdoshëm për zhblokimin e procedurës së pazgjidhur nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe Bashkisë Tiranë. Nëpërmjet shkresës zyrtare, KShH kërkoi informacion nga ana e ASHK-së dhe Bashkisë Tiranë, por nga ASHK nuk na u vu në dispozicion statusi i trajtimit të procedurës, si dhe nuk u ofrua dokumentacioni për të cilin ankuesja ka përmbushur të gjitha detyrimet ligjore.¹¹ Kështu, KShH i është drejtuar për herë të dytë ASHK-së¹², e cila ka mbajtur të njëjtin qëndrim të trajtimit formal të ankesës së përcjellë si dhe referimin e saj ndaj Drejtorisë Vendore të ASHK, për ofrimin e një shërbimi i cili nuk ishte kërkuar në korrespondencën e KShH-së. Pavarësisht tejkallimit të afatit të parashikuar në ligjin për të drejtën e informimit, dhe vënies në dukje të pasaktësisë së konstatuar, nga ana e ASHK-së nuk u përçoll informacioni kërkuar, situatë e cila na detyroi që në përfaqësim të interesave ligjore të ankueses t'i drejtohem Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Ndërhyrjet institucionale për trajtimin e ankesave

Në kuadër të trajtimit të kërkesë/ankesave, KShH i është drejtuar zyrtarisht institucioneve në 78 raste, duke kërkuar kryerjen e verifikimeve sipas fushës së kompetencës dhe marrjen e informacionit prej tyre. Në disa raste, ndërhyrjet kanë synuar në drejtim të dhënies së sugjerimeve apo rekomandimeve për zgjidhjen e ankesave apo rivendosjen në vend të të drejtave të cenuara.

¹⁰ Pas njohjes me përgjigjen e ardhur në rrugë institucionale u pretendua se nga ana e të paraburgosurit ky dëmtim nuk është bërë me dije në momentin e pranimit në IEVP, ndërkohë që për shkak të natyrës së dëmtimit (plagosje me armë zjarri), Komisionari nuk ka ofruar asnjë dokumentacion shpjegues lidhur me këtë fakt.

¹¹ Shkresë nr. 554 prot., dt. 02.08.2021.

¹² Shkresë nr. 628 prot., dt. 17.09.2021.

Ndërhyrjeve institucionale të KShH-së, organet publike i janë përgjigjur për 43% të ankesave të përcjella pranë tyre (ose ndryshe për 34 raste).

Por edhe në këto raste, janë vërejtur tejkalim i afateve ligjore, çka ka sjellë në disa raste ushtrimin nga KShH, të së drejtës së ankimit pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.¹³ Vlerësimi i korrespondencës së KShH-së me institucionet për ankesat evidenton se në veprimtarinë e administratës publike ka ende qëndrime burokratike. Në disa raste kthimi i përgjigjeve dhe verifikimi i pretendimeve të ankuesve nga ana e institucioneve rezultojnë të jetë paraqitur formal. Për këtë arsye, KShH i është drejtuar sërish institucioneve me qëllim marrjen e masave për të kryer hetime administrative objektive, të gjithanshme dhe pa vonesa të ankuesve.¹⁴ KShH me shqetësim ka vërejtur se në disa të adresimit të ankesave të referuara nga ana e shtetasve të dënuar, të diagnostikuar me probleme të shëndetit mendor, IEVP-të kanë reaguar me nota paragjyquese, edhe në rastet kur ankesat janë përcjellë nga familjarët e tyre. Në rastin e shtetasit J.S., të diagnostikuar me *‘çrregullim personaliteti me tipare psikotike’*, KShH i ka sugjeruar institucionit marrjen e masave konkrete me synim garantimin e trajtimit objektiv, të gjithanshëm dhe pa vonesa të ankesave të përcjella nga ana e shtetasve të paraburgosur/dënuar ose kujdestarëve të tyre ligjorë.¹⁵

Është pozitiv fakti se në raste të ankesave të veçanta që KShH i ka drejtuar institucioneve, ka patur një vlerësim të drejtë dhe është shpejtuar zgjidhja e tyre. Kështu, KShH ju drejtua për ankesën e një të dënuari që pretendonte se nuk ishte transferuar për arsye korruptive, ankesë për të cilën, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve referon se me qëllim hetimin dhe zbardhjen e së vërtetës ka bërë referimin e rastit në Shërbimin për Kontrollin e Brendshëm në Sistemin e Burgjeve (SHKBS).¹⁶ Megjithatë, për shumicën e rasteve, rekomandimet e adresuara veçanërisht ndaj IEVP-ve nuk kanë sjellë ndryshimin e situatës së referuar nëpërmjet ankesës, si dhe nuk rezultojnë (referuar përmbajtjes së shkresës) të jenë kryer verifikime të plota dhe objektive për shqetësimet e përcjella nga shtetasit e privuar nga liria.¹⁷

Edhe në kushtet e vështira për shkak të virusit “Covid 19”, ekipi i vëzhguesve të KShH-së ka ndërmarrë 3 misione monitorimi, me qëllim verifikimin e pretendimeve të cënimit të të drejtave dhe lirive, në bazë ankesave të adresuara nga ana e qytetarëve ose të sinjalizuara nga media. Një prej tyre është edhe ai i disa banorëve të Jalës, në Bashkinë e Himarës, të cilët pretenduan mos respektim të rregullave procedurale për njoftimin në kohë të arsyeshme të qytetarëve, për prishjen e banesës së tyre nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT).¹⁸ KShH ju drejtua me shkresë zyrtare IKMT-së për marrjen e informacionit mbi procedurat e ndjekura dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit, por Institucioni nuk ju përgjigj plotësisht kërkesës. Pas një tjetër ndërhyrjeje institucionale dhe vënies në dispozicion të praktikës së plotë, KShH konstatoi se IKMT ka kryer procedura formale, duke u mjaftuar me lënien tek dyert e banesave, të procesverbalit për

¹³ 16 raste përgjatë periudhës kohore Janar – Dhjetor 2021.

¹⁴ Shkresë nr. 143; 143/1; 143/2; 143/3, datë 09.02.2021.

¹⁵ Shkresë nr.149 Prot, datë 11.02.2021.

¹⁶ Shkresa “Kthim përgjigje” nga DPB nr. 424 Prot, datë 23.06.2021

¹⁷ Shkresë nr. 650 Prot, datë 27.09.2021

¹⁸ <https://exit.al/himare-nis-prishja-e-shtepive-ne-himare-banoret-protestojne/>

konstatimin e kundërvajtjes administrative, në një kohë që banesa objekt i shembjes ka qenë e banueshme për një periudhë të gjatë kohe.

4. Reagimet Publike

Përgjatë vitit 2021, KShH ka reaguar publikisht në 21 raste, lidhur me shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut si dhe për ndërgjegjësimin e publikut për tema dhe çështje të ndjeshme, të një rëndësie të veçantë.

Gjashtë prej këtyre reagimeve kanë patur në fokus procesin e zgjedhjeve parlamentare të dt. 25 Prill 2021¹⁹, si reagimin për vonesat e njoftimit me shkrim në banesë të zgjedhësve, sugjerimin për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së kartave të ID të zgjedhësve, në shërbim të një pjesëmarrjeje më të gjërë në ushtrimin e së drejtës së votës, ndarjen e mesazheve ndërgjegjëse lidhur me një fushatë elektorale të qetë, ku të shmanget retorika e gjuhës së urrejtjes dhe incidentet, thirrjen ndaj subjekteve zgjedhore për respektimin e të drejtës për privatësi dhe fshehtësinë e votës (databaza e zgjedhësve), etj²⁰.

Deklarata të tjera kanë shprehur shqetësimin lidhur me ngjarje aktuale që reflektojnë trend në rritje të kriminalitetit në vend, duke vendosur theksin tek parandalimi i tij²¹, lidhur me zjarrëvëniet në disa zona të vendit, duke theksuar nevojën për ndëshkueshmëri dhe mbrojtjen e mjedisit, jetës dhe shëndetit të qytetarëve²², lidhur me krizën energjitike, duke theksuar se masat duhet të jenë proporcionale dhe të merren me një proces që garanton konsultim, llogaridhënie dhe transparencë²³, lidhur me monitorimin që KShH i ka bërë ngjarjes së rëndë të helmimit të rreth 600 banorëve të Qytetit të Krujës, ku sugjeroi hetime pro-aktive dhe të shpejta.²⁴

KShH, në disa raste, në bashkëpunim me organizata të tjera të shoqërisë civile ka reaguar për çështje me interes publik, si psh për procesin e miratimit të paketës ligjore për ndryshimet në kuadrin e ri ligjor të sistemit të drejtësisë nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, i realizuar në mungesë të konsultimit dhe transparencës²⁵, lidhur me Projektligjin “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, si një projektligj që paralelisht me zhvillimet pozitive për heqjen e

¹⁹ <https://ahc.org.al/deklarate-per-shtyp-4/?fbclid=IëAR035pBt7kTJcG5rOHL-xh8AKXXrUQ526-O7ë90ugyDPq5RsZs6MZTa9MTA>

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3395192163937623>

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3544042082385963>

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3614554732001364>

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3622746227848881>

²⁰ Reagim i ardhur për shkak të publikimit në media të të dhënave personale të mbledhura nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste” për qëllime elektorale, në formën e databazës.

<https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3595337783923059/>

²¹ <https://ahc.org.al/njoftim-per-shtyp-rritja-e-kriminalitetit/?fbclid=IëAR1-a6-jcF-oypmUakmp-LIOngvJieKpRKdCEëjI-MsdjGsRStM7MoH0Cc>

²² <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3999920013464832>

²³ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/4123946417728857>

²⁴ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/4187534518036713>

²⁵ <https://ahc.org.al/deklarate-per-media-kuvendi-mirat-on-ndryshime-te-rendesishme-te-reformes-ne-drejttesi-ne-mungese-te-nje-procesi-konsultimi-dhe-transparence/?fbclid=IëAR0o0tFRYACeoh1zvGFFBBTEFXGEecmy45c7nbvpIp9ëTeB9dRAuRGvGAM>

disa burokracie për regjistrimin dhe funksionimin e organizatave, ka gjithashtu regres në parashikime të tjera sa i takon masave sanksionuese, cenimit të parimit të sigurisë juridike dhe të drejtës për organizim.²⁶

Me rastin e 31-vjetorit të themelimit të tij, në bashkëpunim me organizata simotra të Komiteteve të Helsinkit në rajon, KShH ka përpiluar dhe ka shfaqur publikisht një deklaratë të përbashkët, nëpërmjet të cilës bëhet thirrje për më shumë paqe, stabilitet dhe respektim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.²⁷

Gjatë muajit Dhjetor 2021, i menjëhershëm ka qenë reagimi i KShH-së, pas njohjes me përpunimin dhe shpërndarjen e paligjshme të të dhënave personale të rreth 630,000 të punësuarve në sektorin shtetëror dhe privat. Duke evidentuar që ky fenomen ka cënuar rëndë, për të dytën herë privatësinë e qytetarëve (i regjistruar pas publikimit të skandalit të patronazhistëve), KShH përcolli në rrugë zyrtare rekomandime në adresë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Drejtueses së Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

5. Oponencat ligjore në procesin legjislativ

Gjatë vitit 2021, KShH ka shfaqur mendimet dhe sugjerimet e tij modeste për 9 projekt-akte të ndryshme, kryesisht në formën e projektligjeve dhe raporteve të përcjella nga ana e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. projektligje drejuar Kuvendit. Vlen të përmendet se afatet që i janë lënë në dispozicion KShH-së për të shprehur mendimet janë shumë të shkurtra, mesatarisht deri në 5 ditë pune. Afatet e shkurtra ndikojnë negativisht në studimin më të thelluar të këtyre projektligjeve dhe dhënien e kontributeve cilësore. Gjithashtu, vlen të theksohet mungesa e reagimit për sugjerimet që janë marrë në konsideratë dhe ato të cilat nuk janë reflektuar, duke parashtruar shkurtimisht arsyet e refuzimit. Lidhur me këto problematika të konsultimit publik të projekt-akteve, KShH ka informuar Kuvendin.

Ftesa për konsultimin e projekt-akteve të ndryshme janë adresuar edhe nga ana e institucioneve në nivel qendror (ministrive të linjës), si psh për shkak të këtyre afateve të ngushta në kohë brenda të cilave është kërkuar përcjellja e opionioneve të aktorëve të pavarur dhe me burime të kufizuara njerëzore të shoqërisë civile, ndër të cilët KShH, ka qenë i pamundur ofrimi i oponencave efektive dhe cilësore.

Projektligjet e konsultuara nga Kuvendi kanë pasur në fokus shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme për interesin publik, siç janë regjistrimi i organizatave të shoqërisë civile; organizimi dhe funksionimi i shërbimit të kontrollit të brendshëm të sistemit të burgjeve; referendumet; regjistri qendror i llogarive bankare; bashkëqeverisja, ndryshimet e propozuara në kushtetutë për shtyrjen e mandatit të organeve të vettingut.

²⁶ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/photos/3797769633679872>
<https://resourcecentre.al/sq/thirrje-publike-per-projektligjin-per-regjistrimin-e-organizatave-jofitimprurese/>

²⁷ <https://www.facebook.com/KomitetiShqiptarIHelsinki/posts/4331874460269384>

Projektligji “Për bashkëqeverisjen” është kritikuar në këndvështrimin e KShH-së për disa aspekte parimore që centralizojnë ofrimin e shërbimeve dhe kontrollit në institucionin e Kryeministrit, duke spostuar rolin që duhet të luajnë organet e qeverisjes vendore; i kritikueshëm është krijimi i strukturave paralele “të panevojshme” që minimizojnë apo krijojnë mbivendosje me struktura të tjera përgjegjëse të parashikuara në ligje të tjera të posaçme, të cilat kanë të njëjtin qëllim, etj.

KShH ka bërë publik qëndrimin e tij në favor të shtyrjes së mandatit të organeve përgjegjëse të vettingut, përkatësisht të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK) dhe Komisionerëve Publikë (IKP), duke mbajtur në konsideratë opinionin e mëparshëm të Komisionit të Venecias (2016), ngarkesën e dy institucioneve të tjera, përkatësisht Këshillave që do të marrin kompetencat e procesit të vettingut pas mbarimit të afatit të KPK, mbivendosjen e kompetencave të SPAK dhe konfliktet potenciale të interesit, etj.

Me synim nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe demokracisë qytetare, KShH ofroi ekspertizë ligjore për Sindikatën e Fermerëve të Bashkuar, për hartimin e ndryshimeve në ligjin nr. 9817/2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin rural” dhe ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”. Këto amendime të kërkuara nga Sindikata janë mbështetur me nismë ligjore deputeti, për shkak të vështirësive në grumbullimin e nënshkrimeve të nevojshme të 20,000 zgjedhësve gjatë përhapjes së pandemisë globale Covid 19. Disa ditë më parë, u realizua seanca e parë dëgjimore, gjatë së cilës përfaqësuesit e forcave politike pjesë e Komisionit përgjegjës parlamentar mirëpritën propozimet e adresuara si një domosdoshmëri për t’i kushtuar vëmendjen e munguar sektorit të rëndësishëm të bujqësisë në vend.

6. Përfaqësimi i çështjeve me natyrë strategjike për të drejtat dhe liritë e njeriut

6.1 Çështjet e përfaqësuara pranë Gjykatës Kushtetuese

Gjatë muajit Prill 2021, pranë Gjykatës Kushtetuese janë shqyrtuar dy kërkesa të depozituara nga ana e KShH-së, në cilësinë e një organizate që legjitimohet për t’ju drejtuar kësaj gjykate sipas nenin 134 pika 2 të Kushtetutës.

Fillimisht, KShH investoi këtë Gjykatë duke kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të nenit 34, pika 2, gërma gj) dhe 38 pika 2 gërma e) të ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, si dhe nenit 38 pika 2 të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat në Ministrinë e Brendshme”, dispozita të posaçme që parashikojnë përdorimin e testit të poligrafit (makina e së vërtetës) në procedurat e rekrutimit të kandidatëve për drejtues dhe hetues të Byrosë Kombëtare të Hetimit (BKH), si dhe përdorimin e testit psikologjik dhe testeve të tjera, edhe me ndihmën e mjeteve teknologjike të posaçme në kuadër të vettingut në polici. Kërkesa jonë u pranua vetëm pjesërisht nga Gjykata Kushtetuese, vendimet e të cilës janë të formës së prerë dhe të detyrueshme për zbatim. Por pavarësisht nga kjo, ky vendim në vlerësimin tonë ka elementë kontradiktor dhe nuk është arsyetuar plotësisht.

Në kërkesën e dytë drejtuar Gjykatës Kushtetuese, KShH kërkoi shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të nenit 131 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar me ligjin nr. 133/2020, dhe pezullimin e zbatimit të kësaj dispozite deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Gjykatës. Nëpërmjet kësaj dispozite, ligjvënësi i parashikonte një kompetencë të shtuar Policisë së Shtetit gjatë veprimtarisë informativo-gjurmuese, me qëllim përgjimin dhe gjurmimin e autorëve të veprave penale, pa një miratim paraprak nga ana e Prokurorisë.

KShH e mbështeti kërkesën e saj në pretendimin e cënimit të së drejtës së jetës private, nëpërmjet ndërhyrjes jo proporcionale, jo të argumentuar si ndërhyrje e domosdoshme në një shoqëri demokratike. Gjykata Kushtetuese vendosi bashkimin e kërkesës së depozituar nga KShH me kërkesën e depozituar nga ana e Avokatit të Popullit në një çështje të vetme, për shkak të objektit të njëjtë të kërkesave.²⁸ Në përfundim, kjo gjykatë vendosi pranimin e kërkesave duke shfuqizuar dy dispozitat e kundërshtuara në ligjin përkatës.²⁹

6.2. Çështjet e përfaqësuara pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Strasburgut)

Prej gati 10 vitesh, një nga rrugët ligjore që KShH ka ndjekur për përfaqësimin e të drejtave dhe interesave të shtetasve shqiptarë që pretendojnë shkelje të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është përfaqësimi i tyre në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky përfaqësim realizohet pasi këta shtetas kanë ushtruar të gjitha hallkat ligjore të ankimit në sistemin tonë të brendshëm, për kërkimin e të drejtave dhe lirive të tyre. Këto raste njihen ndryshe si çështje të litigimit strategjik, pasi synojnë krijimin e një praktike pozitive për shtetas të tjerë që ndodhen në kushte të ngjashme, duke synuar edhe ndryshime në legjislacion apo ndryshime institucionale në sajë të masave me karakter të përgjithshëm që merr në raste të veçanta Gjykata e Strasburgut.

Gjashtë shtetas të burgosur,³⁰ iu drejtuan KShH-së duke kërkuar mbrojtjen e interesave ligjore të tyre për të mundëuar garantimin e të drejtës për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2017. Kërkuesit pretenduan cënim të nenit 3 Protokollit 1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që garanton të drejtën e votës. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, (i njohur ndryshe si ligji për dekriminalizimin), ndaj këtyre shtetasve vendosej një kufizim absolut mbi të drejtën për të votuar për shkak të ekzekutimit të dënimit të caktuar me vendim të formës së prerë, në kohën e zhvillimit të procesit zgjedhor. Kjo çështje vijon të jetë në shqyrtim nga ana e Gjykatës së Strasburgut, ndërkohë që parashtrimet janë përcjellë pranë Gjykatës nga KShH.³¹

Pas një beteje gjyqësore 10 vjeçare në gjykatat vendase, me përfaqësimin ligjor të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH), shtetasi Fotaq Zaharia ju drejtua Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Ky shtetas, për shkak të mosgarantimit të gamës së nevojshme të pajisjeve/materialeve

²⁸ Shkresë nr. 2 (A) 2021 regj.them., dt. 16.04.2021 “Njoftim për bashkimin e çështjeve” të Gjykatës Kushtetuese

²⁹ Vendim nr. 30, dt. 05.07.2021 https://www.gjk.gov.al/ëeb/Vendime_perfundimtare_100_1.php

³⁰ Çështja Mysliha kundër Shqipërisë, Aplikim nr. 68598/17

³¹ Komunikimi i fundit me Gjykatën mban datën 04.11.2021

mjekësore nga autoritetet shqiptare, prej më shumë se një dekade është në pritje për t'ju nënshtruar një operacioni kirurgjikal. Mungesa e kësaj ndërhyrje e ka përkeqësuar gjendjen e tij shëndetësore, duke i shkaktuar komplikacione të rënda shëndetësore dhe duke e vendosur atë në kushtet e trajtimit ç'njerëzor dhe degradues në sistemin tonë të burgjeve. Me vendimin e dt. 9 Dhjetor 2021, një komitet me tre gjyqtarë i GJEDNJ-së vendosi të ç'regjistrojë kërkesën e ankuesit pasi ka pranuar deklaratën e njëanshme të Qeverisë Shqiptare³². Në këtë deklaratë, autoritetet shqiptare shprehin keqardhjen që i dënuari i është nënshtruar një trajtimi çnjerëzor dhe poshtërues, në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, duke u zotuar ndër të tjerash se do të ofrojnë shërbim adekuat mjekësor, informim të pacientit si dhe do ti paguajnë atij një shumë prej 13,000 euro (trembëdhjetë mijë euro) për të mbuluar çdo dëm material dhe jomaterial, si dhe 2,000 euro (dy mijë euro) për të mbuluar të gjitha shpenzimet plus çdo taksë që mund të t'i ngarkohen aplikantit. GJEDNJ thekson se, nëse qeveria nuk përmbush zotimet e bëra në deklaratën e saj të njëanshme, kërkesa e aplikantit mund të rikthehet në listen e çështjeve të Gjykatës në përputhje me nenin 37, paragrafi 2 i Konventës, duke marrë si referencë çështjen *Josipovic kundër Serbisë* (4 mars 2008).

6.3. Efikasiteti i vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në sistemin tonë të brendshëm

Një vit më parë, KShH përfaqësoi në mënyrë të suksesshme pranë GJEDNJ-së çështjet Prizreni kundër Shqipërisë³³ dhe Strazimiri kundër Shqipërisë.³⁴

Në rastin Prizreni kundër Shqipërisë, Gjykata konstatoi cënim të nenit 2 të KEDNJ (e drejta për jetën) dhe cënim të nenit 3 të KEDNJ në aspektin procedural (ndalimi për t'ju nënshtruar torturës, dënimit a trajtimit çnjerëzor ose degradues). Ky vendim mori formë të prerë në dt. 11.09.2019. Në vijim, KShH informoi Departamentin për Ekzekutimin e Vendimeve të GJEDNJ-së³⁵ mbi të dhënat e nevojshme të ankuesit (vëllait të ankuesit) që mundësojnë kalimin e vlerës së kompensimit të dhënë nga kjo Gjykatë, për shkak të dëmit jo-material.

Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë mori formë të prerë më dt. 21.05.2020. Ndaj shtetasit Arben Strazimiri, gjykatat vendase kishin pushuar çështjen penale dhe kishin caktuar masë mjekësore “mjekim i detyruar”, por si rezultat i mungesës së një institucioni të posaçëm mjekësor, ky shtetas prej vitesh mbahet në kundërshtim me ligjin në sistemin e burgjeve. Në këtë rast, GJEDNJ konstatoi cënim të neneve 3 (ndalimi për t'ju nënshtruar torturës, dënimit a trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe neneve 5 § 1 dhe 5 § 4 (e drejta për liri dhe siguri) të KEDNJ. GJEDNJ njohu të drejtën e kërkuar për dëmshpërblim të drejtë, në përputhje me nenin 41 të Konventës. Në këtë rast, GJEDNJ aplikoi edhe nenin 46 të Konventës, duke vendosur Shqipërinë para detyrimit për zbatimin e masave të një karakteri të përgjithshëm, në mënyrë të menjëhershme, për të siguruar kushtet e duhura të jetesës dhe shërbimet e kujdesit të duhur shëndetësor për personat e sëmurë mendërisht, të cilët janë të privuar nga liria në kushtet e mjekimit të detyruar me vendim gjykatë. Sipas GJEDNJ, shteti shqiptar duhet të krijojë

³² Shih vendimmarrjen e gjykatës në këtë lidhje [https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:\[%22001-214319%22\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{%22itemid%22:[%22001-214319%22]})

³³ Aplikim nr. 29309/16

³⁴ Aplikim nr. 34602/16

³⁵ Shkresat nr. 614, dt. 22.11.2019 dhe nr. 619, dt. 25.11.2019 të lëshuara nga KShH

“institucionin e duhur”, duke pajisur godinat ekzistuese ose ndërtesën e një godine të re të specializuar për strehimin e personave si kërkuesi, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës. Një godinë e tillë duhet të respektojë qëllimin terapeutik të kësaj forme të kufizimit të lirisë, me synimin për të kuruar ose lehtësuar gjendjen e shëndetit mendor të të ndaluarve, duke përfshirë ku është e mundur, një reduktim ose kontroll mbi rrezikshmërinë e tyre dhe lehtësimin e riintegritit të tyre në shoqëri. Trajtimi farmakologjik duhet të kombinohet me forma të tjera të njohura për trajtimin terapeutik, si pjesë e një plani të individualizuar trajtimi për secilin individ. Për këto qëllime, autoritetet duhet të sigurojnë edhe rekrutimin e një numri të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar të kujdesit për shëndetin mendor, në këto godina. Si masë individuale, GJEDNJ urdhëron autoritetet të sigurojnë me urgjencë administrimin e formave të përshtatshme dhe të individualizuara të terapisë për Arben Strazimirin, dhe të marrin në konsideratë mundësinë për ta vendosur atë në një mjedis alternativ jashtë institucioneve për ekzekutimin e vendimeve penale.

Pas kërkesës zyrtare të KShH-së për informacion, Avokatura e Shtetit Shqiptar ka vendosur në dispozicionin tonë, planet e veprimtimit të hartuara për ekzekutimin e vendimeve të sipërcituara, të cilat janë paraqitur pranë Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës. KShH vlerëson pozitive marrjen e masave konkrete nga ana e legjislativit mbi amendimet e realizuara nëpërmjet ligjit nr. 35/2017 në Kodin e Procedurës Penale, që datojnë në fakt para vendimit të GJEDNJ-së për çështjen Prizreni kundër Shqipërisë.³⁶

Pavarësisht hartimit të këtyre planeve, KShH konstaton se asnjë prej vendimmarrjeve nuk është ekzekutuar sa i përket shpërblimit të drejtë që GJEDNJ i ka akorduar kërkuesve. Për vendimin Strazimiri kundër Shqipërisë, lidhur me masat me karakter të përgjithshëm dhe individual, rezulton se me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve më dt. 27-28 Nëntor 2021 ka ekzekutuar transferimin e 314 shtetasve me masë mjekësore nga IEVP Zahari Krujë, në dy godinat e përshtatura në IEVP Shënkoll (Lezhë).³⁷ KShH ka reaguar publikisht duke vlerësuar pozitivisht vendimin e mbylljes së burgut të Zaharisë, si më problematiku në vend, për shkak të infrastrukturës dhe kushteve të këqija, të cilat vendosnin shtetasit me liri të kufizuar në pozita të trajtimit ç’njerëzor dhe poshtërues,

KShH rithekson qëndrimin e tij se IEVP Shën Koll ku janë transferuar shtetasit burra me masë mjekësore “mjekim i detyruar” është një institucion i sistemit të burgjeve, në administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Rrjedhimisht, dy godinat akomoduese nuk plotësojnë kërkesat e një institucioni të posaçëm të kujdesit shëndetësor për shtetasit me masë mjekësore. Gjithashtu, nga informacioni i vënë në dispozicion nga DPB, tërheq vëmendjen numri i ulët i mjekëve psikiatër dhe psikologë, konkretisht 2 mjekë e 2 psikologë, në raport me numrin e lartë të shtetasve të kategorizuar nën ekzekutimin e masës mjekësore. Në vlerësimin e KShH-së, vijon të jetë sërisht problematik vijueshmëria e mbajtjes së vajzave dhe grave me masë mjekësore, në ambientet e Qendrës Spitalore të Burgjeve.

³⁶ Këto ndryshime lejojnë përfshirjen e të afërmeve të viktimës në hetimet mbi vdekjen e familjarit të tyre si dhe njoftimin dhe garantimin e pjesëmarrjes së trashëgimtarëve të viktimës në procedurat përpara Gjykatës, në rastet e kërkesës së Prokurorit për pushimin e akuzës ose çështjes. Zbatueshmëria e këtyre amendimeve ligjore u përkrah edhe nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili nëpërmjet urdhërit nr. 5, datë 26.10.2018 “Për garantimin e asistencës së viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale”, synoi unifikimin e kuptimit dhe zbatimit të dispozitave të ndryshuara në legjislacionin procedural penal.

³⁷ Informacion i përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nëpërmjet shkresës nr. 12815/2 prot., dt 03.12.2021

7. E drejta e informimit në epokën e re dixhitale dhe në situatën e pandemisë globale

7.1. Ankesat për informacion pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

E drejta e informimit, përbën një të drejtë të rëndësishme kushtetuese që garanton informimin e çdo njeriu, publikut dhe transparencën e institucioneve, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Për garantimin efektiv të respektimit të së kësaj të drejte është krijuar me ligj një institucion i pavarur me rëndësi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Komisioneri).

Komisioneri njihet dhe ka akses në informacionin dhe dokumentet, objekt ankimi, sipas ligjit “Për të drejtën e informimit” apo që lidhen me çështjen në shqyrtim, duke përfshirë edhe informacione të klasifikuara “sekret shtetëror”.

Në përputhje me misionin të tij, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka adresuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 16 ankime administrative, përgjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021. Shkaku i këtyre ankimeve është mosdërgimi plotësisht apo pjesërisht i informacionit të kërkuar, nga disa institucione publike në vendin tone, në cenim të afateve ligjore të parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”³⁸³⁹.

Aspekt shumë i rëndësishëm i punës së KShH-së është garantimi i respektimit të të drejtave të personave të cilët ndodhen në kushtet e kufizimit të lirisë. KShH, në funksion të këtij fokusi, ka iniciuar ankim administrativ kundrejt IEVP Zahari, lidhur me mosdërgimin e informacionit të kërkuar nga ky institucion.⁴⁰

Gjithashtu, KShH, në ushtrim të misionit të tij për respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës, ka adresuar kërkesë për informacion drejt Bashkisë Fier, e cila nuk ka ofruar informacion të plotë lidhur me pyetjet e adresuara nga banorët e Fshatit Çerven. Pas marrjes së këtij ankimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale zhvilloi një seancë dëgjimore publike (ndikur nga kushtet e Covid 19 në formatin online⁴¹) me pjesëmarrjen e palëve, në të cilën përcaktoi një afat brenda të cilit autoriteti publik, Bashkia Fier duhej të kthente përgjigje të plota, për pyetjet e adresuara nga KShH në kërkesën për informacion. Edhe pas kalimit të këtij afati, autoriteti nuk ktheu një përgjigje të plotë lidhur me pyetjet e drejtuara⁴² dhe nga ana e Komisionerit nuk u ndërmorën hapa apo sanksione të mëtijshme për të detyruar këtë autoritet publik të kthejë përgjigje. Nga ana e autoritetit publik informacioni u përcoll rreth 9 ditë pune me vonesë.⁴³

³⁸ Si psh rasti i disa bashkive të vendit, të cilat nuk kanë vendosur në dispozicion informacionin statistikor dhe cilësor lidhur me rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve të dënuar në prag lirim ose pas lirim.

³⁹ Si psh, rasti i ankimit administrativ kundrejt shkresës Nr.65 Prot, datë 15.01.2021 të KQZ, e cila nuk adresonte informacionin e kërkuar tërësisht.

⁴⁰ Nëpërmjet shkresës Nr. 253 Prot, datë 03.07.2020

⁴¹ Séance dëgjimore e mbajtur më dt. 23.04.2021.

⁴² Afati i përcaktuar në seancën dëgjimore është dt. 28.04.2021

⁴³ Informacioni është përcjellë nga ana e autoritetit publik më dt. 10.05.2021.

7.2. Impakti i vendimmarrjeve të Komisionerit dhe roli i tij në raport me institucionet publike

Nisur nga numri i konsiderueshëm i ankimeve që KShH i ka përcjellë Komisionerit gjatë këtij viti, vërehet se gjatë procedurës së hetimit administrative pranë Komisionerit, organet publike ndaj të cilave është paraqitur ankimi kanë ofruar informacionin e kërkuar në 15 raste. Në asnjë rast, ndaj këtyre institucioneve nuk janë marrë masa administrative për moszbatimin e ligjit për të drejtën e informimit. Komisioneri, përpara se të marrë një vendim, i ka kërkuar autoritetit publik të ofrojë një qëndrim lidhur me pretendimin e ngritur nga ankuesi duke rivlerësuar kërkesën për informacion brenda një afati të caktuar. Vetëm në rast mosveprimi nga ana e autoritetit brenda afatit të caktuar, Zyra e Komisionerit, sipas shkresave të dërguara drejt autoriteteve, ka parashtuar se do të vlerësojë mbi ndjekjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me nenin 18 dhe 24 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Në një nga rastet për të cilat i jemi drejtuar me ankim Komisionerit, u vlerësua se ankesa jonë ishte jashtë objektit të ligjit dhe se kishte të bënte me detyrën funksionale të autoritetit publik për trajtimin e praktikave individuale⁴⁴. Ky është rasti i një qytetareje që j’u drejtua KShH-së pasi nuk merrte informacion nga Drejtoria Vendore Tiranë dhe Agjensia Shtetërore e Kadastrës, për shërbimin e kërkuar për t’u pajisur me certifikatën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme⁴⁵. Në përpjekje për të ndihmuar këtë qytetare, KShH ju drejtua këtyre institucioneve për të përcjellë ankesën e qytetares si dhe për të kërkuar informacion për trajtimin e saj. Pas mungesës së një përgjigje nga ana e institucioneve, u bë ankim administrativ tek Komisioneri. Në fakt, kjo vendimmarrje në vlerësimin e KShH-së është e kritikueshme, pasi qytetarët kanë të drejtë të informohen mbi procedurat që janë duke kryer nga organet publike për trajtimin e ankesave si dhe zgjidhjet (nëse ka patur) prej tyre, të lidhura me çdo shërbim që ata kërkojnë apo aplikojnë. Ky është një informacion zyrtar që çdo individ që bën një ankesë duhet ta disponojë. Mungesa e një përgjigjeje është shkelje e së drejtës së informimit. Në vlerësimin tonë, vendimmarrja e Komisionerit mund të favorizojë praktikën jo transparente të organeve publike, për këtë aspekt të rëndësishëm të punës së tyre, në kontaktet që kanë me qytetarët që kërkojnë shërbime.

7.3. E drejta për informacion përkundrejt nevojës për mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe parimit të prezumimit të pafajësisë

E drejta për informim nuk është një e drejtë absolute, që nënkupton se kjo e drejtë mund t’i nënshtrohet kufizimeve. Neni 10 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut mbron lirinë e shprehjes, e cila përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike. M gjith, në paragrafin 2 të këtij neni parashikohen kufizimet, të cilat duhet të jenë të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.

⁴⁴ Nr.Prot 778, date 11.11.2021

⁴⁵ Pavarësisht pagesës së akorduar në rrugë zyrtare prej saj.

Gjatë periudhës parazgjedhore, nisur nga një databazë me të dhëna personale dhe sensitive që qarkullonte dhe sinjalizohej në media, se administrohej nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste”, në dt.14 Prill 2021, KShH reagoi me deklaratë publike duke kërkuar që subjektet zgjedhore të respektojnë të drejtën për privatësi dhe fshehtësinë e votës. Subjektet zgjedhore nuk mund të mbajnë të dhëna personale dhe sensitive të zgjedhësve, pa miratimin paraprak të tyre. KShH kërkoi nga organi i prokurorisë të informojnë me transparencë dhe paanshmëri publikun, nëse janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme për hetimin e plotë dhe të paanshëm të përgjegjësve të krijimit të saj dhe nëse janë përfshirë institucione shtetërore për kalimin e të dhënave. Vlen të theksohet se në fillim të muajit Tetor të këtij viti, media informon se për procedimin penal të kësaj çështje, prokuroria e posaçme ka shpallur moskompetencën, duke e dërguar për kompetencë në prokurorinë e Tiranës, me arsyetimin se nuk ka element të veprave penale të korrupsionit aktiv apo pasiv në zgjedhje⁴⁶. Kjo vendimmarrje e SPAK ka interes të lartë publik, për shkak të të dhënave personale apo sensitive që janë mbajtur dhe përpunuar për afro 900,000 zgjedhës. M gjith ajo nuk gjendet e publikuar në faqen zyrtare të SPAK. Është e paqartë nëse hetimet e kryera janë realizuar edhe ndaj drejtuesve të institucioneve qendrore apo të pavarura, për elementë të lidhur me veprën penale të shpërdorimit të detyrës. E themi këtë pasi këto institucione, ndaj të cilave media ka ngritur dyshime se të dhënat janë marrë pikërisht prej tyre, kanë përgjegjësi për mbajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale të bëra publike⁴⁷. Hetimi i Prokurorisë së Posaçme, në përputhje me kompetencën lëndore dhe rrethin e subjekteve, duhet të shtrihet edhe ndaj zyrtarëve të lartë publikë të institucioneve shtetërore, të cilat dyshohen se kanë nxjerrë apo transferuar të dhënat. KShH vëren se mungesa e përgjegjshmërisë dhe pandëshkueshmëria cënon besimin e qytetarëve tek shteti i së drejtës si dhe dobëson demokracinë. Edhe pse kanë kaluar gati 10 muaj nga ngjarja, ende nuk ka përgjegjësi lidhur me këtë çështje.

Më dt. 19 Gusht 2021, në faqen zyrtare të institucionit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) u publikua një relacion, i cili ofronte informacion mbi procedurën e hetimit administrativ kryesisht (*ex officio*) që ky institucion ka ndërmarrë për përhapjen e paligjshme të këtyre të dhënave.⁴⁸ Gjithashtu, zyra e Komisionerit ka marrë dhe ka trajtuar rreth 81 ankesa të adresuara nga qytetarë të ndryshëm kundrejt entiteteve publike ose private. Hetimi administrative i KDIMDP-së evidentoi se asnjë nga partitë politike në vendin tonë nuk e ka plotësuar formularin e njoftimit të KDIMDP për përpunimin e të dhënave personale të qytetarëve. KDIMDP dha disa rekomandime ndaj Partisë Socialiste në gusht të vitit

⁴⁶ Shih artikujt/kronikat e publikuara në këto lidhje:

<https://www.oraneës.tv/vendi/spak-i-kalon-dosjen-e-patronazhisteve-prokurorise-tirane-nuk-u-vertetua-ko-i1010947>
<https://faktoje.al/si-firuan-dosjet-per-krimet-zgjedhore-dhe-moskompetenca-e-spak-qe-shfryu-patronazhistet/>

⁴⁷ Sipas nenit 75/a, gërma “c” e Kodit të Procedurës Penale, Spak dhe Gjykatat e Posaçme kanë kompetencë lëndore për çdo akuzë penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anetarit të Keshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendesministrit, anetarit të Keshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Keshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të percaktuara në Kushtetutë ose në ligj;


⁴⁸ [Relacion hetimi administrative per perhapjen e paligjshme te te dhenave personale te shtetasve.pdf \(idp.al\)](#)

të kaluar⁴⁹. Disa nga rekomandimet drejtuar ndaj këtij subjekti nuk përmbajnë një afat të qartë për tu përmbushur, por referohen për t'u adresuar në vazhdimësi.

Gjithashtu, sa i takon hetimit administrativ të realizuar ndaj AKSHI, në Relacionin e publikuar në faqen e KDIMDP⁵⁰ thuhet se përgjigjet e AKSHI, rezultojnë të paqarta dhe jo në përputhje me dispozitat normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij kontrolluesi, analizuar kjo nga perspektiva e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga ana tjetër, sipas nenit 32 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit ka të drejtë të sigurojë të gjithë informacionin që ajo kërkon në përmbushjen e detyrave të saj, si dhe t'i akordohet akses në sistemet që kryejnë përpunimin e të dhënave personale dhe në të gjithë dokumentacionin që lidhet me përpunimin dhe transferimin e tyre nga ana e AKSHI. Në relacion referohet se informacioni është përcjellë në rrugë shkresore dhe mbetet e paqartë në rast se është realizuar inspektim i mëtejshëm me qëllim realizimin e një hetimi të plotë dhe të gjithëanshëm.

KShH vlerëson se Zyra e Komisionerit duhet të kishte shtrirë më tej hetimin administrativ ndaj këtij subjekti, për sa kohë ka konstatuar që përgjigjet e AKSHI janë të paqarta. Referuar ligjit Nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” (Neni 30) dhe Kodit të Procedurës Administrative, neni 81, KDIMDP, si organ kompetent kishte hapësirën ligjore për të kërkuar dhe për tu njohur me të gjitha faktet të cilat janë të nevojshme për marrjen e vendimit përfundimtar, duke përdorur për këtë qëllim të gjitha metodat e të provuarit të lejuara nga ligji për një hetim administrativ efikas dhe ezaures.


Disa nga rekomandimet e shprehura në këtë Relacion përmbledhen si më poshtë:



⁴⁹ Rekomandime janë adresuar gjithashtu ndaj institucioneve publike, të cilat në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi kanë kompetenca në raport me garantimin e përpunimit të të dhënave personale të shtetasve, si ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit.

⁵⁰ [Relacion hetimi administrative per perhapjen e paligjshme te te dhenave personale te shtetasve.pdf \(idp.al\)](#) fq 27

Rekomandime lidhur me sistemet përkatëse të menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale:



Në muajin Dhjetor 2021 qarkulluan nëpërmjet rrjetit Whatsapp, fillimisht dy databaza me të dhëna personale të rreth 630,000 të punësuarve në sektorin shtetëror dhe privat në lidhje me numrin e identifikimit, punëdhënësit dhe pagat e muajit janar dhe prill 2021. Pas disa ditësh u publikua një tjetër bazë të dhënash me të dhëna për pronarët e automjeteve, duke përfshirë modelin dhe targën për secilin prej tyre. Një numër i papërcaktuar qytetarësh kanë akses në këto baza të të dhënave për shkak të shpërndarjes së tyre.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit, adresoi një shkresë drejtuar Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁵¹ ku kërkoi ndërmarrjen e veprimeve të menjëhershme për të urdhëruar bllokimin dhe fshirjen e përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale nga Zyra e Komisionerit si dhe rekomandoi që hetimi i filluar nga prokuroria të jetë i plotë, objektiv dhe i gjithëanshëm, duke i kushtuar rëndësi edhe motivit të kësaj ngjarjeje ku të dhënat personale të qytetarëve i kanë kaluar të tretëve pa autorizimin e tyre, duke shkelur rëndësi privatësinë e tyre dhe mund të përbëjë cënim të nenit 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (E drejta për respektimin e privatësisë dhe jetës private). Zyra e Komisionerit ka referuar në shkresën kthim përgjigje⁵² se nga ana e Zyrës së Komisionerit, kanë filluar dy procese hetimi administrativ si dhe janë ndërmarrë një sërë ndërhyrjesh institucionale, duke qenë se adresimi i kësaj problematike kërkon ndërveprim institucional ndërmjet një sërë institucionesh.

Sipas legjislacionit shqiptar, KDIMDP është autoriteti përgjegjës dhe i pavarur që mbikëqyr dhe monitoron mbrojtjen e të dhënave personale. Në këtë drejtim, nevojitet një vlerësim objektiv parlamentar nëse buxheti, burimet njerëzore dhe kapacitetet e KDIMDP-së, mundësojnë kryerjen e kontroleve periodike në të gjitha subjektet publike dhe private që janë “Kontrollues” apo “Kontrollues të mundshëm” të të dhënave personale të qytetarëve. Vlen të theksohet se niveli i njohurive dhe reagimit të qytetarëve shqiptarë mbi legjislacionin për të dhënat personale dhe mjetet juridike që shtetasit kanë në dispozicion kur ka shkelje, rezulton në nivel shumë të ulët.

Përgjatë muajit Janar 2022, nga burime mediatike u bë e ditur që ishin gjetur 4 persona përgjegjës për ngjarjen, të cilët ishin arrestuar nga Prokuroria Tiranë. Më tej, nga ana e mediave është bërë e ditur që Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka marrë vendimin për lirim të 4 personave të arrestuar si përgjegjës të publikimit të të dhënave personale të qytetarëve, duke caktuar masat e sigurisë 'detyrim paraqitje' për ekspertin e IT të Tatimet si dhe 'arrest shtëpie' për 3 të arrestuarit e tjerë, ekspertin tjetër të IT të Tatimet, si dhe dy përmbaues privat.⁵³ Një vendimmarrje e tillë rezulton se është mbështetur në pranimin e rolit të ‘bashkëpunëtorit të drejtësisë’ të pranuar nga ana e të pandehurve.

KShH i bën thirrje medias për të balancuar në mënyrë sa më profesionale dhe etike, të drejtën për të dhënë informacion tek publiku, me nevojën për të respektuar dinjitetin njerëzor apo të drejtat dhe liritë e njeriut. E themi këtë pasi veçanërisht në median audiovizive por edhe atë online, vërehen raste të cënimit të parimit të prezumimit të pafajsisë, në mbulimin e ngjarjeve të kronikës së zezë të lidhura me kriminalitetin në vend. Individët e dyshuar etiketohen si autorë të veprës, ndërkohë që ende nuk ka filluar hetimi dhe gjykimi ndaj tyre. Publikimi i të të Dhënave personale dhe sensitive të të miturve autorë apo viktimë e veprës penale, cenon privatësinë dhe mund të krijojë pasoja të dëmshme në shëndetin e tyre mendor. Në këtë drejtim, etika dhe profesionalizmi i medias ka nevojë të forcohet, duke konsoliduar mekanizmat vetë-rregullues të medias dhe

⁵¹ Shkresa nr. 881 Prot, datë 24.12.2021

⁵² Shkresë nr. 2159/1 Prot, datë 06.01.2021

⁵³ Shih artikujt e publikuara në këto lidhje:

<https://a2neës.com/2022/01/10/skandali-i-publikimit-te-pagave-lirohen-kater-te-arrestuarit/>

<https://shqiptarja.com/lajm/nje-thes-me-akuza-kush-eshte-gjyqtari-qe-liroi-nga-burgu-4-te-arrestuarit-qe-nxorren-nesh-te-dhenat-personale?r=kh5>

promovuar prej tyre praktika pozitive të gazetarëve. Ky sugjerim nuk nëkupton dobësimin e kritikës apo investigimeve që media kryen dhe kanë kontribuar pozitivisht në denoncimin e rasteve me interes të lartë publikë. Nga ana tjetër, vlen të adresohet shqetësimi i shumë gazetarëve të intervistuar në kuadër të Barometrit Kombëtar për Lirinë e Shprehjes, se kanë qenë të detyruar të vetë-censurohen ose ndeshen me raste të censurës në redaksitë ku punojnë apo pronarët e medias.

Zhvillimet e teknologjisë së informacionit dhe rritja e përdoruesve të internetit dhe rrjeteve sociale kanë bërë që edhe në vendin tonë të ketë shqetësime për gjuhën e urrejtjes, bullizmin dhe cenimin e privatësisë së njerëzve.

Vazhdon të mbetet shqetësuese gjuha e urrejtjes e përdorur në parlamentin e vendit tonë nga deputetë të maxhorancës apo opozitës, për të cilin KShH ka reaguar pothuajse çdo vit. Rasti më i fundit ishte ai i shqyrtimit të projektligjit për buxhetin e shtetit në parlament, ku deputetët shfaqën sjellje agresive dhe gjuhë urrejtjeje mes tyre. Sjellje të tilla e dëmtojnë kulturën dhe etikën parlamentare, duke përçarur modele negative të sjelljes dhe komunikimit të parlamentarëve në publik. Pasiguria e krijuar nga situata e vështirë e pandemisë apo problemet e tjera me kriminelitetin që vendi ynë ka, thellohet edhe më shumë kur debatet që i serviren në Kuvend janë të tilla, të cilat nuk përcjellin vlera themelore të respektimit të dinjitetit njerëzor dhe të drejtave dhe lirive të njeriut.

